



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 5 , Datë 14.12.2012

Për

Miratimin e projekt-idesë të "Projekti Hidroenergjitik mbi lumin Devoll".

Në zbatim të pikës dh. neni 4. kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2012, mori në rishqyrtim projekt-idenë për "Projektin hidroenergjitik të Devollit", i hartuar nga firma projektuese "Devoll Hydropower" ku bëjnë pjesë digat e Banjës, Kokel dhe Moglicë për këtë objekt.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi diskutoi Projekt-idenë e Skemës së lumit Devoll dhe të digave Banjë, Kokel, Moglicë pas sqarimeve e plotësimeve nga ana e firmës projektuese "Devoll Hydropower":

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë për digat Banjë, Kokel, Moglic. me treguesit e mëposhtëm:

Emërtimi i Digës	Kuota e nivelet normale të rezervuarit	Tipi i digës
1. Diga Moglicë	650.0 m	Përbërje shkëmbore me bazament qëndror asfalti.
2. Diga Kokel	350.0 m	E kombinuar, betoni me mbushje shkëmbore dhe shtresë asfalti.
3. Diga Banjë	175.0 m	Material vendi, bërtham qëndrore, me bazament Argjile.

Për përgjigjet e dhëna me shkresën Ref.2012-Tr-00222 datë.26.06.2012 nga Devoli Hidropower Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha vendosi që janë të plotësuara kërkesat e sygjerimet për projekt-idenë "Projekti Hidroenergjitik të Devollit".

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha kërkon që në fazën e **projekt-zbatimit** të plotësohen pikat e mëposhtme:

1. Ujitja është prioritet dhe në koncensionet e Hec-ve shënohet "Që të mos çenohet kërkesa për Bujqësinë". Ndërkaq, këtu problem është jo vetëm për pellgun e Devollit poshtë Banjës, po është ndërtuar kanali me  $Q=20\text{m}^3/\text{s}$  për dërgimin e ujit në pellgun e Shkumbinit. Pra, edhe nëse nuk ka specifikime për kohën dhe sasinë e lëshimit të ujit për bujqësinë dhe kur të kërkojë bujqësia këtë atëherë do të ketë problem sociale. Ne mendojmë që të specifikohet mundësia e dhënies sipas zgjidhjes së dhënë dhe të ketë një marrveshje me Ministrinë e Bujqësisë.
2. Përgjigjia e dhënë nga ana juaj është e papërshtatshme në reduktimin e prurjeve maksimale të shkarkimit në mënyrë që të mos shkaktojnë përmytje në zonën fushore që shtrihet në anën e poshtme të digës Banjë. Nga ana e KKDM është kërkuar që të klasifikoni Riskun në anën e poshtme të Banjës dhe të korigjoni zgjidhjen nëse është e nevojshme. Risku kërkohej të jetë në nivelin e Riskut normal. Klasifikimi të bëhet me metodën e pikëzimit të faktorëve të riskut që janë: Vulnerabiliteti dhe Faktori i lidhur me pasojat e kolapsit të veprës.
3. Vendimi i KKDM është i vlefshëm me ndryshimin me ligj të ligjit nr.10083 datë 22.02.2009, "Konfirmimin e Skemës përfundimtare, shfrytëzimi i lumit Devoll me tre digat : Banjë, Kokël dhe Moglicë.

#### Mbi aspektet sizmike.

1. Lidhur me pikën 6.1, vërejmë së pari që në fq. 10/14 "tërmeti i projektimit" MDE është referuar me periudhë kthimi (përsëritje) të gabuar ( $RP=200\text{vjet}$ ). Është një lapsus. Aty bëhet fjalë në fakt për rekomandimin tonë (mbështetur në rekomandime të ICOLD-it) për vlerën  **$RP=2\ 000\ \text{vjet}$** .
2. Po për këtë pikë (6.1, fq 10/14), thuhet se «..projektimi i digave të Devollit bazohet në premisën se digat do të jenë të afta të përballojnë një tërmet  **$1/1\ 500\ \text{vjet}$** ..». Por, në fq 11/14 e në vijim nuk jepet asnjë e dhënë dhe nuk ka asnjë konsiderim llogaritës mbi nxitimin sizmik që i përket kësaj vlere të  **$RP (=1\ 500\ \text{vjet})$** .
3. Po për këtë pikë (6.1, fq 11/14) thuhet se «.....sipas Eurokodit,  $a_h$  supozohet të jetë 0.5 PGA...». Dihet se Eurokodi 8 i projektimit të strukturave rezistente ndaj tërmetit nuk i trajton digat. Prandaj, mendojmë se argumenti i mësipërm nuk qendron.
4. Së fundi, për këtë pikë (6.1) mendojmë se argumentet e dhëna në fq 13/14 lidhur me zgjedhjen e akselerogramave llogaritëse **nuk** mund dhe **nuk** duhet të përjashtojnë konsiderimin **edhe** të një tërmeti «gati lokal» dhe të fortë, siç ka qënë ai i Malit të Zi, i 15 Prillit 1979, me magnitudë  $M=7.2$ , i cili dëmtoi shumë edhe disa rajone të territorit të

Shqipërisë. Për gjetjen e regjistrimeve të tij akselerografike mendojmë se mund të konsultohet Departamenti i Sizmologjisë, pranë Institutit të Gjeo-shkencave... (IGJEUM) – Tiranë.

5. Lidhur me pikën 6.2 (fq 13/14), kërkojmë që nga ana e projektuesit të merren parasysh aspektet e vërejtura më sipër për pikën 6.1.

Me respekt,

Peri DISHNICA  
KRYETAR

